



Viti i X-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2019

SHPESHTËSIA E ANEMISË FERRO-DEFICITARE NË MOSHAT PEDIATRIKE

Edmont Laho*, Xhejni Borshi**

* Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Albanian University, Tiranë, Shqipëri

** Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Albanian University, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: lahoe90@gmail.com

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi është që të nxjerrë në pah sëmundjet më të shpeshta dhe problematike të pacientët e shtruar në shërbimin e pediatriisë, dhe në veçanti, shpeshtësinë dhe shkallën e anemive hypokrome. Në këtë punim janë studiuar të gjitha rastet e pacientëve të shtruar në shërbimin tonë gjatë viteve 2009 – 2012. Rastet e punimit tonë janë studiuar në drejtim të diagnozës klinike, moshës, ecurisë etj. Nga rezultatet e studimit tonë del qartë se patologjitë më kryesore në moshat pediatrike janë sëmundjet pulmonare të ndjekura nga sëmundjet e traktit gastro-intestinal. Ndërsa rastet me anemi ferro-deficitare kapin 40,8% të rasteve të shtrimeve me patologji të ndryshme. Moshat që predominon anemitë është nën 4 vjeç.

Fjalë çelës: sëmundshmëri, sistemi gastro-intestinal, anemi ferro-deficitare.

FREQUENCY OF THE HYPOCROMOUS ANEMIA IN PEDIATRICS

Abstract

The purpose of this paper is to highlight the most frequent and problematic diseases in patients undergoing paediatric care and in particular the frequency and degree of hypochromous anemia. In this paper we have studied all cases of patients hospitalized in our service during the years 2009

– 2012. Our cases have been studied in terms of clinical diagnosis, age, progress, and so on. From the results of our study is clear that the major pathologies in paediatric ages are pulmonary diseases followed by diseases of the gastro-intestinal tract. Cases with ferro-infectious anaemia account for 40.8% of cases with different pathologies. The predominant age in anemia is under 4.

Keywords: *fatigue, gastro-intestinal system, iron-deficiency anemia.*

Hyrje

Patologjitë e moshës pediatrike janë më të shpeshta kur vizitat dhe shtrimet në shtrimet në spital janë më të larta se moshat e të rriturve. Patologjitë më të shpeshta në moshat pediatrike janë sidomos deri në 4 vjeç, ku predominojnë infeksionet e traktit respirator dhe ato të traktit tretës, virozat pas infeksioneve urinare etj. Në të gjitha rastet e shtruara në spital vërehet një shifër e lartë e anemive hipokrome. Anemia ferro-deficitare është më e shprehur te fëmijët nën moshën 3 – 4 vjeç dhe në pacientët që vijnë nga zona rurale. Rastet e shumta që kanë qenë në gjendje të rëndë dhe kanë kërkuar më shumë ditë qëndrim në spital, kanë qenë me anemi ferro-deficitare të shprehur. Kjo është mjaft e shpjegueshme që anemi ferro-deficitare në vartësi të shkallës, jep ulje të shprehur të imunitetit dhe këta fëmijë janë pjesë e kontingjentit që pësojnë infeksione të përsëritura të njëpasnjëshme.

Qëllimi

1. Të vlerësojë ecurinë e sëmundshmërisë në shërbimin e pediatrikë.
2. Të japë të dhëna për veçoritë e patologjive të ndryshme të lidhura me anemitë ferro-deficitare.
3. Të vlerësojë shpeshtësinë dhe shkallën e anemisë ferro-deficitare.
4. Të mbikëqyrë dhe të parandalojë aneminë te fëmijët me dhënien e hekurit te nënat shtatzëna.

Materialet dhe metoda


Ky studim ka të bëjë me të dhëna retrospektive në vitet 2009 – 2011 janë analizuar dhe studiuar të gjitha shtrimet të bëra në shërbimin e Pediatrikë në Qendrën Spitalore Rajonale Elbasan. Nga të gjitha rastet, janë studiuar në mënyrë më të detajuar shtrimet me patologji dhe infeksionet

respiratore, gastro-intestinale, urinare etj. Kriteret e studimit ishin diagnoza e shtrimit dhe e daljes, duke i ndarë sipas formave klinike, ecurisë, pranisë, dhe për shkallën e anemisë ferro-deficitare duhet që hemoglobina të jetë nën 11 gr/dl, etj. U anketuan rreth 300 nëna (që kishin fëmijët e sëmurë) për përdorimin e preparateve të hekurit dhe kalciumit gjatë shtatzënisë tyre.


Rezultatet

Gjatë viteve 2009 – 2011 janë shtruar në shërbimin tonë spitalor, 2896 pacientë nga mosha 4-javësh deri në 14 vjeç. Këta pacientë janë studiuar fillimisht për të parë peshën që zënë patologjitë kryesore.


Grafiku 1. Patologjitë pediatrike më të shpeshta



Gjatë viteve 2009 – 2011 janë shtruar në shërbimin tonë spitalor 2896 fëmijë, nga këta pacientë të shtruar me sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes 891 raste ose 31%, nga infeksione të traktit tretës 695 raste ose 23.5%, nga viroza 330 raste ose rreth 11,5% dhe infeksione të aparatit urinar 110 raste ose 3,8% raste etj.


Grafiku 2. Shpeshësia e anemisë ferro-deficitare në pacientët e spitalit

Nga gjithë rastet e shtruara gjatë kësaj periudhe në spital vërehet që 1186 ose 40,8% të shtruarve me patologji të ndryshme, kryesisht të aparatit respirator dhe gastro-intestinal, paraqesin anemi ferro-deficitare.

Grafiku 4. Anemia ferro-deficitare sipas grupmoshave


Siç duket dhe nga grafiku i mësipërm, anemia ferro-deficitare në rastet e shtruara në spital është më e lartë kryesisht në fëmijët 0 – 1 vjeç dhe 1 – 4 vjeç, përkatësisht 38% dhe 29% në krahasim me moshat të tjera.

Grafiku 5. Anemia ferro-deficitare e lidhur me mungesën e marrjes së hekurit te nënat shtatzëna




Në studim u bë anketimi i 300 nënave që kanë pasur fëmijët të shtruar në spital, ku krahas infeksionit për të cilin ishin shtruar, kishin dhe anemi hipokrome. Nga anketimi rezultoi që 38% e tyre nuk kishin përdorur hekur apo preparate të hekurit gjatë shtatzënisë apo në muajt e fundit të saj.

Grafiku 6. Anemia ferro-deficitare sipas vendbanimit



Në studimin tonë duket qartë se rastet më të shprehura të shtruar në spital me anemi ferro-deficitare vijnë nga zonat rurale, me 65% të rasteve.

Grafiku 7. Anemia sipas ushqyerjes

Në grafikun 7 duket qartë që pacientët që kanë bënë ushqyerje me ushqim artificial kanë më të shprehur aneminë ferro-deficitare, me 59%.

Diskutim

Në studimin tonë del në pah që sëmundjet më të shpeshta në moshën pediatrike janë infeksionet e traktit respirator me rreth 31% të ndjekura nga infeksionet dhe çrregullimet e traktit gastro-intestinal me 24,5% pas virozat 11% dhe infeksionet urinare 4,1%. Këtu duket qartë që patologjitë më të shpeshta të moshës pediatrike janë sëmundjet pulmonare, të ndjekura nga ato të sistemit tretës. Kjo mbështet dhe nga literatura që infeksionet e traktit respirator janë në vendin e parë (1, 2). Gjatë studimit tonë, që kishte si qëllim të vlerësonte dhe prevalencën e anemisë ferro-deficitare në të gjitha rastet e shtruara, u konstatua që shpeshtësia e anemisë arrin në 40,8%. Ky është një tregues që anemia hipokrome apo ferro-deficitare është e lartë, ku ajo varion nga 15 – 20% në vendet e zhvilluar deri në 40 – 55% në vendet e pazhvilluar. Për sa i përket shtrirjes së grup-moshave të anemive u konstatua që moshë 0 – 1 vjeç dhe 1 – 4 vjeç zënë pjesën më të madhe me 39 dhe 28% (6). Kjo është më se e shpjegueshme që fëmijët e moshave nën 4 vjeç, dhe sidomos nën 1 vjeç, kanë të shprehur kequshqyerjen fillimisht të nënave shtatzëna, të cilat përgjatë shtatzënisë, dhe sidomos në 3 mujorin e fundit të shtatzënisë, nuk marrin preparatet e hekurit dhe vitamina që të plotësojnë nevojat me hekur dhe elemente të tjera për fetusin e ardhshëm. Arsye tjetër e shkakut të anemisë së lartë ferro-deficitare është dhe kequshqyerja e fëmijëve të vegjël që marrin jo vlerat e duhura, madje në zonat rurale vazhdojnë të ushqehen me qumësht lope. Kjo konkretizohet nga studimi ynë ku me pacientët që kanë qenë ushqyer me ushqim artificial zënë 59%. Nga na tjetër, duke studiuar anemitë në vartësi të vendbanimit, konstatojmë që rastet që

vijnë nga zonat rurale zënë 65% . Veç të tjerave ky është një tregues që anemia ferro-deficitare shkaktohet kryesisht nga kequshqyerja e fëmijëve, prematuranca (5), dhe me pas faktorë të tjerë, si: diarre e zgjatur, parazitë etj.

Në studimin tonë, sipas Figurës 6, në anketimin që është bërë në 300 nëna, me fëmijët në vitin e parë dhe të dytë të jetës të shtruar në shërbimin tonë u konstatua që mbi 38% të nënave (që kanë pasur fëmijët në studimin tonë) kur kanë qenë shtatzëna nuk kam marrë hekur dhe kalcium. Ky është një tregues i rëndësishëm që tregon për neglizhencën e kulturës shëndetësore të prindërve, por dhe punës së dobët të sistemit profilaktik shëndetësore në vendin tonë.

Praktika dhe literatura ka treguar qartë që mos trajtimi i anemive ferro-deficitare shkakton uljen e imunitetin, pengon rritjen normale të fëmijëve dhe zhvillimin intelektual të tyre (4). Në studimin tonë u pa qartë që rastet me infeksione të aparatit respirator, pastro-intestinal etj., që kishin ecuri të rëndë dhe të zgjatur kishin prezent aneminë ferro-deficitare nën 9 gr/dl.

Përfundime

1. Mostrajtimi i zgjatur i nënave shtatzëna me preparatet e hekuri dhe vitaminave është faktor risku për zhvillimin e anemisë për fëmijët.
2. Të dhënat e punimit tonë treguan qartë se patologjitë më të shpeshta në moshën pediatrike janë sëmundjet e sistemit respirator të ndjekura nga sëmundjet dhe çrregullimet gastro-intestinale.
3. Prevalenca e anemisë ferro-deficitare është e lartë deri në 40,8%.
4. Moshat që preken më shpejtë dhe më shumë nga anemia ferro-deficitare janë grupmoshat 0 – 1 vjeç dhe nga 1 – 4 vjeç.
5. Në studimin tonë u konstatua anemia ferro-deficitare, më e shprehur në zonat rurale deri 65%.

Referenca

1. Bekteshi S. *Pediatrics* vol. 2. 1974, f. 17, 48, 49.
2. Bebeci D. *Pediatrics* botim IV. Tiranë, 2006, f. 17, 18 128-130.
3. Haas JD, Brownlie T IV. Iron deficiency and reduced work capacity: a critical review of the research to determine a causal relationship. *J Nutr* 2001;131:676S--690S.
4. Grantham-McGregor S, Ani C. A review of studies on the effect of iron deficiency on cognitive development in children. *J Nutr* 2001;131:649S--668S.
5. Rasmussen KM. Is there a causal relationship between iron deficiency or iron-deficiency anemia and weight at birth, length of gestation and perinatal

- mortality? J Nutr 2001;131:590S--603S.
6. Koci L. Sëmundje Pediatrike. Tiranë, 2005, f. 139, 140, 141.
 7. Ludwig S. Pediatric at a Glance. Philadelphia, 2000, p. 230, 231, 232, 234.
 8. W. Paul Glezen M.D. Epidemiology of Acute Lower Respiratory Diseases in Children. 1973. N. England J med 288, 498-505.
 9. Prober CG Pneumonia. In Nelson Textbook of Pediatric, ed 15 Edited by Behram PE 1996, p. 716 -721.
 10. Forrester C. Children's Medicine. London. 1996, 151-156.
 11. Nelson Textbook of Paediatric 16 Edition W.B. Saunders Company. Year 2000.
 12. Paul F, Basch. Textbook of International Health. Second Edition 114-125.
 13. Pediatria nën Drejtimin e Prof. Dr Eli Foto.Tiranë, 2014, f. 91-595.
 14. Fëmija, rritja dhe zhvillimi. Dr. Drita Demiri. Elbasan, 2017, f. 232-237.
 15. Anemia në sëmundjet kronike të veshkave. Dr. Arjan Hamiti, 2016, f. 23-30.
 16. Bailey RL, West KP, Black RE. The epidemiology of global micronutrient deficiencies. Ann Nutr Metab. 2015; 66: 22-33.